



757  
05.06.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 436, datë 3.6.2020

P Ë R

**PËRCAKTIMIN E KRITERIT TË NOTËS MESATARE PËR PRANIMIN  
E KANDIDATËVE NË PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË  
DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT  
TË DYTË OSE TRANSFERIMIN E STUDIMEVE NË VITET  
E NDËRMJETME TË KËTYRE PROGRAMEVE, NË INSTITUCIONET  
E ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021 DHE 2021-2022  
E NË VIJIM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 74, të ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kanë të drejtë të aplikojnë për t'u pranuar në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2020-2021, përkatësisht, si më poshtë:
  - a) Në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, kandidatët, që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të lartë minimalisht me notë mesatare 6.5 (gjashtë pikë pesë);
  - b) Në programet e studimit të gjuhëve të huaja, të përcaktuara në shtojcën nr.1, të këtij vendimi, minimalisht me notë mesatare 7 (shtatë);

- c) Në programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor”, të cilat japin akses në programet e ciklit të dytë “Master” në fushën e mësuesisë, të përcaktuara në shtojcën nr.2, të këtij vendimi, minimalisht me notë mesatare 7.5 (shtatë pikë pesë).
2. Kanë të drejtë të aplikojnë për t’u pranuar në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2021-2022 dhe në vijim, përkatësisht, si më poshtë:
    - a) Në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, kandidatët që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të lartë minimalisht me notë mesatare 7 (shtatë);
    - b) Në programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor”, të cilat japin akses në programet e ciklit të dytë “Master” në fushën e mësuesisë, të përcaktuara në shtojcën nr.2, të këtij vendimi, minimalisht me notë mesatare 8 (tetë).
  3. Përjashtohen nga detyrimi i plotësimit të kriterit të notës mesatare kandidatët që aplikojnë për t’u pranuar në programet e studimeve dyvjeçare, me karakter profesional, kandidatët që aplikojnë për t’u pranuar në programet e studimeve në fushën e artit dhe të sportit, si dhe kandidatët me origjinë shqiptare nga Republika e Kosovës, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci.
  4. Në rastet e transferimit të studimeve nga brenda apo jashtë vendit, në vitet e ndërmjetme të programeve të studimit, brenda të njëjtit cikël, studentët duhet të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave të vitit akademik që studenti është pranuar në institucionin e arsimit të lartë, duke filluar nga viti akademik 2016–2017 dhe në vijim.
  5. Nota mesatare për pranimin në institucionet e arsimit të lartë përlllogaritet si mesatare e thjeshtë e treguesve, si më poshtë vijon:
    - a) mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave përfundimtare vjetore të lëndëve për të gjitha vitet e shkollimit në arsimin e mesëm të lartë;
    - b) mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave të provimeve të Maturës Shtetërore.
  6. Institucionet arsimore të arsimit të mesëm të lartë dhe institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, janë përgjegjëse për përlllogaritjen e notës mesatare dhe dërgimin e këtyre të dhënave në Qendrën e Shërbimeve Arsimore.
  7. Procedurat për njëvlershmërinë e dokumenteve të paraqitura nga shtetasit shqiptarë dhe të huaj, të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë jashtë vendit, si dhe përlllogaritja e notës mesatare për këta kandidatë të kryhen në Qendrën e Shërbimeve Arsimore, sipas përcaktimeve të pikës 5, të këtij vendimi. Në rastet kur nuk aplikohen provimet e Maturës Shtetërore, komisioni përkatës përcakton mënyrën e përlllogaritjes së notës mesatare. Komisioni përkatës dërgon të dhënat tek institucioni arsimor vendor përkatës, përgjegjës për arsimin parauniversitar.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, institucionet e arsimit të mesëm të lartë, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

MINISTRI I ARSIMIT,  
SPORTIT DHE RINISË

**BESA SHAHINI**

### SHTOJCA 1

(Programet e studimit të gjuhëve të huaja për vitin akademik 2020-2021)

<b>Nr.</b>	<b>INSTITUCIONII ARSIMIT TË LARTË</b>	<b>PROGRAMI I STUDIMIT</b>	<b>NOTA MESATARE</b>
1	<b>Universiteti i Tiranës</b>	Gjuhë angleze	7
2		Gjuhë angleze (Sarandë)	7
3		Gjuhë frënge	7
4		Gjuhë gjermane	7
5		Gjuhë greke	7
6		Gjuhë italiane	7
7		Gjuhë ruse	7
8		Gjuhë turke	7
9		Gjuhë spanjolle me profil gjuhë - letërsi dhe qytetërim hispanik	7
<b>Nr.</b>	<b>Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"</b>	<b>PROGRAMI I STUDIMIT</b>	<b>NOTA MESATARE</b>
1		Gjuhë angleze	7
2		Gjuhë frënge	7
3		Gjuhë gjermane	7
4	Gjuhë italiane	7	
<b>Nr.</b>	<b>Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës</b>	<b>PROGRAMI I STUDIMIT</b>	<b>NOTA MESATARE</b>
1		Gjuhë gjermane dhe angleze	7
2	Gjuhë Angleze	7	
<b>Nr.</b>	<b>Universiteti "Fan S. Noli", Korçë</b>	<b>PROGRAMI I STUDIMIT</b>	<b>NOTA MESATARE</b>
1		Gjuhë angleze	7
		Gjuhë dhe kulturë frënge	7
<b>Nr.</b>	<b>Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë</b>	<b>PROGRAMI I STUDIMIT</b>	<b>NOTA MESATARE</b>
1		Gjuhë angleze	7
2	Gjuhë italiane	7	
<b>Nr.</b>	<b>Universiteti "Luigi Gurakuqi", Shkodër</b>	<b>PROGRAMI I STUDIMIT</b>	<b>NOTA MESATARE</b>
1		Gjuhë angleze	7
2		Gjuhë frënge	7
3		Gjuhë gjermane	7
4	Gjuhë italiane	7	
<b>Nr.</b>	<b>Kolegji universitar "Logos"</b>	<b>PROGRAMI I STUDIMIT</b>	<b>NOTA MESATARE</b>
1		Gjuhë dhe civilizim grek	7
<b>Nr.</b>	<b>Kolegji universitar "Bedër"</b>	<b>PROGRAMI I STUDIMIT</b>	<b>NOTA MESATARE</b>
1		Gjuhë dhe letërsi angleze	7
<b>Nr.</b>	<b>Universiteti privat "Albanian University"</b>	<b>PROGRAMI I STUDIMIT</b>	<b>NOTA MESATARE</b>

1		Anglisht	7
<b>Nr.</b>	<b>Universiteti</b>	<b>PROGRAMI I STUDIMIT</b>	<b>NOTA MESATARE</b>
1	"Eqrem Çabej", Gjirokastrë	Histori dhe gjuhë italiane	7

## SHTOJCA NR. 2

(Programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor”, të cilat japin akses në programet e ciklit të dytë “Master” në fushën e mësuesisë, për vitin akademik 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim)

Nr.	INSTITUCIONI I ARSIMIT TË LARTË	PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE VITI AKADEMIK 2020-2021	NOTA MESATARE VITI AKADEMIK 2021-2022 DHE NË VIJIM
1	<b>Universiteti i Tiranës</b>	Biologji	7.5	8
2		Filozofi	7.5	8
3		Fizikë	7.5	8
4		Gjeografi	7.5	8
5		Gjuhë - Letërsi	7.5	8
6		Histori	7.5	8
7		Informatikë	7.5	8
8		Kimi	7.5	8
9		Matematikë	7.5	8
10		Psikologji	7.5	8
11		Sociologji	7.5	8
Nr.	<b>Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”</b>	PROGRAMI I STUDIMIT	NOTA MESATARE	NOTA MESATARE
1		Biologji - Kimi	7.5	8
2		Edukim qytetar	7.5	8
3		Filozofi - Sociologji	7.5	8
4		Gjeografi dhe gjuhë italiane	7.5	8
5		Gjuhë shqipe dhe letërsi	7.5	8
6		Histori - Gjeografi	7.5	8
7		Histori dhe gjuhë gjermane	7.5	8
8		Matematikë informatike	7.5	8
9		Matematikë - Fizikë	7.5	8
10		Mësuesi për arsim parashkollor	7.5	8
11		Mësuesi për arsim fillor	7.5	8
12		Psikologji	7.5	8
13	Gjuhë shqipe dhe frënge	7.5	8	

14		Gjuhë shqipe dhe rome	7.5	8
<b>Nr.</b>	<b>Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës</b>	<b>PROGRAMI I STUDIMIT</b>	<b>NOTA MESATARE</b>	<b>NOTA MESATARE</b>
1		Gjuhë-Letërsi- Anglisht	7.5	8
2		Histori	7.5	8
3		Informatikë – Anglisht	7.5	8
4		Matematikë - Informatikë	7.5	8
5		Mësuesi për arsim fillor	7.5	8
6		Mësuesi për arsim parashkollor	7.5	8
7		Psikologji	7.5	8
8		Filozofi - Sociologji	7.5	8
<b>Nr.</b>	<b>Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastrë</b>	<b>PROGRAMI I STUDIMIT</b>	<b>NOTA MESATARE</b>	<b>NOTA MESATARE</b>
1		Biologji - Kimi	7.5	8
2		Gjuhë - Letërsi shqipe	7.5	8
3		Gjuhë-Letërsi angleze	7.5	8
4		Gjuhë - Letërsi dhe Qytetërim grek	7.5	8
5		Gjuhë - Letërsi italiane	7.5	8
6		Histori - Gjeografi	7.5	8
7		Matematikë - Informatikë	7.5	8
8		Mësuesi për arsimin fillor	7.5	8
9		Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5	8
10		Fizikë dhe teknologji informacioni	7.5	8
11	Matematikë - Fizikë	7.5	8	
<b>Nr.</b>	<b>Universiteti "Fan S. Noli", Korçë</b>	<b>PROGRAMI I STUDIMIT</b>	<b>NOTA MESATARE</b>	<b>NOTA MESATRE</b>
1		Biologji - Kimi	7.5	8
2		Filozofi - Sociologji	7.5	8
3		Gjuhë - Letërsi	7.5	8
4		Histori - Gjeografi	7.5	8
5		Matematikë - Fizikë	7.5	8
6	Matematikë - Informatikë	7.5	8	

7		Mësuesi për arsimin fillor	7.5	8
8		Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5	8
<b>Nr.</b>	<b>Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë</b>	<b>PROGRAMI I STUDIMIT</b>	<b>NOTA MESATARE</b>	<b>NOTA MESATRE</b>
1		Biologji	7.5	8
2		Fizikë	7.5	8
3		Gjuhë shqipe dhe Letërsi	7.5	8
4		Histori - Gjeografi	7.5	8
5		Informatikë	7.5	8
6		Kimi	7.5	8
7		Matematikë	7.5	8
8		Mësuesi për arsimin fillor	7.5	8
9		Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5	8
10	Pedagogji e specializuar	7.5	8	
<b>Nr.</b>	<b>Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër</b>	<b>PROGRAMI I STUDIMIT</b>	<b>NOTA MESATARE</b>	<b>NOTA MESATRE</b>
1		Biologji - Kimi	7.5	8
2		Fizikë	7.5	8
3		Gjeografi	7.5	8
4		Gjuhë - Letërsi	7.5	8
5		Histori	7.5	8
6		Informatikë	7.5	8
7		Matematikë	7.5	8
8		Mësuesi për Arsim Fillor	7.5	8
9		Mësuesi për Arsim parashkollor	7.5	8
10	Psikologji	7.5	8	
<b>Nr.</b>	<b>Kolegji universitar "Bedër"</b>	<b>PROGRAMI I STUDIMIT</b>	<b>NOTA MESATARE</b>	<b>NOTA MESATRE</b>
1		Arsimi parashkollor dhe fillor	7.5	8
2	Psikologji këshillimi dhe Pedagogji	7.5	8	
<b>Nr.</b>	<b>Kolegji universitar "Ëisdom"</b>	<b>PROGRAMI I STUDIMIT</b>	<b>NOTA MESATARE</b>	<b>NOTA MESATRE</b>
1.		Psikologji	7.5	8
<b>Nr.</b>	<b>SHLUJ, Universiteti "Marin Barleti"</b>	<b>PROGRAMI I STUDIMIT</b>	<b>NOTA MESATRE</b>	<b>NOTA MESATRE</b>
1		Psikologji	7.5	8



<b>Nr.</b>	<b>Universiteti European i Tiranës</b>	<b>PROGRAMI I STUDIMIT</b>	<b>NOTA MESATARE</b>	<b>NOTA MESATRE</b>
1		Psikologji	7.5	8
2		Sociologji	7.5	8
3		Filozofi	7.5	8
4		Histori	7.5	8
5		Letërsi	7.5	8
6		Linguistikë	7.5	8
7		Arsim parashkollor	7.5	8
<b>Nr.</b>	<b>Universiteti i Neë York-ut në Tiranë</b>	<b>PROGRAMI I STUDIMIT</b>	<b>NOTA MESATARE</b>	<b>NOTA MESATRE</b>
1		Psikologji	7.5	8
<b>Nr.</b>	<b>Universiteti privat "Albanian University"</b>	<b>PROGRAMI I STUDIMIT</b>	<b>NOTA MESATARE</b>	<b>NOTA MESATRE</b>
1		Mësuesi për arsimin fillor	7.5	8
2		Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5	8
3		Psikologji e përgjithshme	7.5	8
<b>Nr.</b>	<b>Kolegji universitar "Logos"</b>	<b>PROGRAMI I STUDIMIT</b>	<b>NOTA MESATARE</b>	<b>NOTA MESATRE</b>
1		Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5	8